



*Departamenti i Prokurimit*

*Prishtinë: datë, 07.08.2020*

*Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 05.08.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "International Security Association" për aktivitetin: "Sigurimi fizik i objekteve të Komunes" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-3238-211 nxjerr:*

**V E N D I M**

*REFUZOHET kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "International Security Association" e datës 05.08.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Sigurimi fizik i objekteve të Komunes" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-3238-211 kundër Njoftimit për Vendimin e AK-se të datës 03.08.2020, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.*

*Vertetohet Njoftimi për Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 03.08.2020 ; Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.*

**A r s y e t i m**

*Operatori Ekonomik "International Security Association" me datë 05.08.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sigurimi fizik i objekteve të Komunes" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-3238-211. Autoriteti Kontraktues, me datë 07.08.2020 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:*

*Pretendimet tuaja janë të pa bazuara për arsye të vijim:*

- Pretendimi juaj se tenderi juaj nuk është trajtuar në mënyrë të barabartë me tenderet tjere është plotësisht i pa bazuar për faktin se vlerësimi i tenderit tuaj dhe i tenderëve tjere është bërë në harmoni me të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit, sqarimet plotësuëse që janë dërguar në periudhën para hapjes së tenderit, me rekomandimet e Vendimeve të OSHP-se dhe interpretimet e ATK-se, të cilat janë kërkuar me rekomandim të Vendimeve të OSHP-se;*
- Pretendimi juaj se Ak-ja ka refuzuar tenderin tuaj si tender jonormalisht të ulët në kundërshtim me Vendimin e OSHP-se dhe ekspertizës është paashtu i pa qëndrueshëm, pasi që në Njoftimin për refuzimin e tenderit tuaj, arsyeja e refuzimit është se çmimi i tenderit tuaj nuk*

mbulon te gjitha detyrimet financiare sipas Ligjit te Punes dhe nuk kemi te bejme me rregullat per tenderet jonormalisht te ulet;

-Lidhur me pretendimin se nuk eshte respektuar neni 38 i LPP-se ju sqarojme se çdo veprim ne te gjitha fazat e vleresimeve dhe rivleresimeve eshte bere ne harmoni me ate nen, si qe jane ne harmoni edhe te gjitha kerkesat e FDT-se dhe se lidhur me kete ju sqarojme si vijon: do të paraqesim përcaktimin e procedurës të kontratës kornizë nga neni 38 i Ligjit të Prokurimit Publik dhe nenit 56.10 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik.

Neni 38.2.i LPP-se eshte si vijon: Asnjë kontratë publike kornizë nuk do të ketë kohëzgjatje më shumë se 36 muaj. Kontrata publike kornizë nuk mund të zgjatet apo të ri-përtërihet dhe kushtet e saj nuk mund të ndryshohen.

Nga ky formulim shihet qartë se përcaktohet afati maksimal i kohëzgjatjes së kontratës kornizë dhe nuk kufizohet kohëzgjatje nën atë afat, e që është përcaktuar qartë me nenin 56.10 të RRUOPP-së:

Sasia e parashikuar e specifikuar në dokumentet e tenderit është vetëm sasi indikative. Kurdo qe Autoriteti kontraktues specifikon sasinë indikative, Autoriteti kontraktues do të specifikojë në dosjen e tenderit vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan dhe do të lejojë devijimin prej tij, duke deklaruar gjithashtu përqindjen e mospërputhjes së lejuar.

Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus tridhjetë përqind (30%). Nëse urdhër blerjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + tridhjetë përqind (30%), pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht.

Pra nga kjo shihet qartë se kontrata kornizë duhet të ndërpritet kur tejkalon plus 30% nga vlera e parashikuar dhe ky sqarim është dhënë për të gjithë OE-ik të interesuar për pjesëmarrje ne këtë aktivitet.

-Lidhur me pretendimet se vlersimi nuk eshte bere ne harmoni me nenin 59 pika 3 ju sqarojme se edhe me rastin e ketij rivleresimi Autoriteti Kontraktues eshte bazuar ne kriteret e matshme e ne harmoni me Vendimet e OSHP-se dhe ne asnje rast nuk eshte vleresuar asnje kriter qe nuk eshte paraqitur nga AK-ja me rastin e Njoftimit per kontrate dhe sqarimeve vijuese ne baze te kerkesave te OE-ik te interesuar per pjesemarrje ne kete aktivitet;

-Poashtu edhe pretendimi juaj se AK-ja gjete rivleresimit nuk ka pase ne konsiderate neni 1 te LPP-se ju sqarojme qellimi i ketij neni nenkupton se shfrytezimi efikas i fondeve publike gjithmone nenkupton pos tjerash edhe dhenjen e kontrates tenderuesit te pergjegjshem ,tenderi i te cilit eshte ne perputhje me kerkesat e perzgjedhjes,e jo shperblimin e tenderueseve qe nuk plotesojne keto kerkesa.

Bazuar ne konstatimet paraprake konstatoj se pretendimet tuaja jane te pa bazuara dhe kerkesa juaj refuzohet.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

  
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit